



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
INSPEKTORATI I MBROJTJES SË TERRITORIT
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I PROKURIMEVE

Nr. _____ Prot

Tiranë _____. _____. 2024

Shtojca 11

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

[25.01.2024]

Drejtuar: [“KASTRATI” shpk me adresë: Durrës Lagja 14, Rruga Tirana, Prane Gjykares se Apelit, Shkozet]

Procedura e prokurimit/lotit:

Lloji i procedurës së prokurimit: E hapur, mallra, **Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik**

Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF-91238-12-18-2023

Objekti i kontratës: “Blerje Karburanti për mjetet e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë për vitin 2024-2025”

Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP):) 09134000-7

Fondi limit: **11,666,666** (njëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH

Kohëzgjatja e kontratës: 24 muaj nga data e hyrjes ne fuqi e Marreveshjes Kuader

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike Buletini Nr. 103 datë 26 Dhjetor 2023

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “A&T” SHA

L32320008H

“2A2F - L OIL”

L41915013M

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera

1. Vlera e marzhit te fitimit: 16.8 leke/liter.

Vlera totale e ofertës: 10,756,359.5 (dhjetë milion e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e pesëdhjetë e nëntë pikë pesë) lekë pa TVSH.

2. “KASTRATI” shpk

J61813529P

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera e marzhit të fitimit: **17 (shtatëmbëdhjetë) leke/liter.**

Vlera totale e ofertës : 10,850,414.9 (dhjetë milion e tetëqind e pesëdhjetë mijë e katërqind e katërmëdhjetë pikë nëntë) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1.Oferta e paraqitur nga Bashkimi i operatorve ekonomik “**A&T shpk & 2A2f-L OIL” shpk**, Vlera e marzhit të fitimit: 16.8 leke/liter.

Vlera totale e ofertës : 10,756,359.5 (dhjetë milion e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e pesëdhjetë e nëntë pikë pesë) lekë pa TVSH.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të pikës 2, të nenit 92, të Ligjit ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, pikës 3, neni 82 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 92 të Ligjit ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 82 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ,I ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator Ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

AK në kriteret e veçanta të kualifikimit ka kërkuar si më poshtë cituar:

2.3.1 *Operatori ekonomik fitues detyrimisht duhet të të disponojë minimumi 2 (dy) pika shpërndarje karburanti ne rrethin e Tiranës, vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (akt pronësie, kontratë noteriale qeraje/furnizimi, ose të jenë të pasqyruara ne ekstraktin e QKB, etj), si dhe të dorëzojë një listë të pikave të karburantit me adresa të sakta të cilat do të shërbejnë për furnizimin e makinës së institucionit ose marrveshje me të tretët nëse ka.*

2.3.2 *Të gjitha stacionet e tregtimit me pakicë të karburanteve të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor detyrimisht duhen të jenë të pajisur me dokumentacion si më poshtë:*

a) Licencë lëshuar nga pushteti vendor për tregtim karburantesh me pakicë;

b) Leje mjedisore përkatëse lëshuar nga QKL;

c) Vërtetim teknik lëshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK); d) Certifikatë e mbrotjes nga zjarri nga M.Z.SH;

e) Police sigurimi në një nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, për distributoret e shitje me pakice, të cilat duhet të jenë brenda afatit të vlefshmërisë me datën e hapjes së ofertave;

në përmbushje të kriterëve të sipërcituara bashkimi i Operatorve Ekonomikë ka deklaruar listën me 2 (dy) pika shpërndarje karburanti në Bashkinë Tiranë, konkretisht: me adresë:

1. Rruga Shemsi Haka Ali Dem
2. Rr. Dritan Hoxha Laprakë

shoqëruar me dokumentacionin përkatës.

Për të 2 (dy) pikat e shitjes së karburantit në Tiranë të listuara mësipër, në përmbushje të pikës a) **Licencë lëshuar nga pushteti vendor për tregtim karburantesh me pakicë;** të kriterit 2.3.2 Bashkimi i operatorëve ekonomik ka paraqitur: kërkesat drejtuar Bashkisë Tiranë për pajisjen me licencë për funksionimin e stacioneve të shitjes së karburanteve dhe jo licencat përkatëse, siç kërkohet në DST.

Aplikimi (Kërkesa) nuk vërteton pajisjen me **“Licencë lëshuar nga pushteti vendor për tregtim karburantesh me pakicë;”**

Nga sa më sipër BOE nuk përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.8 germa a), të seksionit 2.3, Kapaciteti Teknik të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit.

KVO gjykon, Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi dhe operatorët ekonomikë janë të detyruar të paraqesin ofertat në përputhje me kërkesat në dokumentet e tenderit dhe në zbatim të LPP çdo ofertë e cila nuk është dorëzuar në përputhje me kërkesat në dokumentet e tenderit do të refuzohet.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 3, të nenit 92, të Ligjit ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, pikës 2, neni 82 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ,I ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [“KASTRATI” shpk me adresë:Durrës Lagja 14, Rruga Tirana, Prane Gjyqates se Apelit, Shkozet/], se oferta e paraqitur me vlerë totale prej Vlera e marzhit te fitimit: **17 (shtatëmbëdhjetë) leke/liter.** Vlera totale e ofertës: 10,850,414.9 (dhjetë milion e tetëqind e pesëdhjetë mijë e katërqind e katëmbëdhjetë pikë nëntë) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor: ***Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë, Adresa: Rr: “Abdi Toptani”, 1001, Tiranë,*** sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe procedura do të anulohet duke qenë se ju jeni ofertues i vetëm i kualifikuar në këtë procedurë, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

ublik”.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO JO X

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO

JO

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*)____